




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



Kuvendi i Komunës

01Nr. 1984 2013

Dt. 03 / 04 / 2013

Ne mbështetje të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligji Nr. 04/L-144. Ne zbatim të rregullores Komunale Për Procedurat e Dhënies së Objekteve të Komunës dhe Tokës për Shfrytëzim Afatshkurtër Përmes Ankandëve Nr. 01-1974 si dhe Vendimit për dhënie të pronës komunale me qira në shfrytëzim afatshkurtër Nr. 01-1972. Komisioni Vlerësues për Zbatimin e Procedurave për Dhënie në Shfrytëzim të pronës së Paluajtshme Komunale nën Autorizimet e marra me vendim të Kuvendit Komunal shpallë:

ANKAND PUBLIK

Ftohen të gjithë të interesuarit që të dorëzojnë ofertat e tyre për marrjen në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 vite, të pronës Komunale të evidentuar në tabelën vijuese;

Komuna	Zona Kadastrale	Certifikata e pronësisë Nr. UL	Numri i Ngastrës	Lloji i Kulturës	Sipërfaqja në Hektar	Çmimi Fillestar €/Muaj
Deçan	Dranoc	70505026-00336	1098	Mal klasa III	10.72.10	1.500,00 €

Kriteret për të qenë pjesëmarrës (konkurrues) në ankand janë

- kopja e dokumenteve identifikuese (për personat Fizik)
- certifikata për regjistrimin e Biznesit (për persona Juridik)
- certifikatën për kryerjen e obligimeve tatimore nga ATK-ja jo më e vjetër se tre muaj nga dita e aplikimit.
- dëshminë për lënien e depozitës në njërin nga bankat e licencuara pran autoriteteve bankare të Kosovës (minimum pagesa mujore e qerash).
- plani i biznesit për shfrytëzim të ngastrës dhe burimet e financimit (disponueshmëria financiare për aktivitetin)
- pasqyrat financiare trevjeçare dhe auditimi nga persona apo kompani të licencuara për auditim
- dëftesa për pagesën e taksës administrative për pjesëmarrjen

Kriteret e vlerësimit te ofertave:

- Çmimi me i favorshëm ekonomik - 40% te vlerësimit
- Plani me i suksesshëm afarist dhe disponueshmeria financiare (burimet e financimit) - 30% te vlerësimit
- Lloji i veprimtarisë se investimit dhe numri i punëtorëve te inkuadruar ne biznes 30% te vlerësimit.

Afati i Fundit i dorëzimit te ofertave

- 30 dite nga dita e publikimit te ankandit deri me 03.05.2013 ne ora 14:00

-

Hapja e Ofertave

- 06.05.2013 ne sallën e konferencave objekti i Komunës Deçan ne ora 14:00

SHENIM:

Dokumentet për ofertim merren ne Objektin e Komunës Deçan zyra Nr. 21

DOKUMENTACIONET QE NUK I PLOTESOJNE KRITERET E KONKURIMIT NUK DO MERREN NE KONSIDERIM NGA KOMISIONI.

Data 03.04.2013

